


**EMIGRIMI I DETYRUAR I SHQIPTARËVE GJATË LUFTËRAVE
BALLKANIKE (1912-1913) DHE NDIKIMI I TYRE NË STRUKTURËN
SHOQËRORE DHE EKONOMIKE**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË**

**NGA
ALBIONA JASHARI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

KORRIK, 2026

REZYME

“EMIGRIMI I DETYRUAR I SHQIPTARËVE GJATË LUFTËRAVE BALLKANIKE (1912-1913) DHE NDIKIMI I TYRE NË STRUKTURËN SHOQËRORE DHE EKONOMIKE”

Mentori: Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani

Kandidatja: Albiona Jashari

Ky punim trajton emigrimin e detyruar të shqiptarëve gjatë Luftërave Ballkanike (1912–1913), duke analizuar shkaqet që çuan në shpërnguljen masive të popullsisë shqiptare, drejtimit e migrimit dhe pasojat afatshkurtra e afatgjata që ky proces pati në strukturën shoqërore dhe ekonomike të shqiptarëve. Luftërat Ballkanike shënuan një nga periudhat më të vështira në historinë shqiptare, pasi pushtimet ushtarake, dhuna sistematike dhe ndryshimet territoriale detyruan mijëra shqiptarë të braktisnin trojet e tyre. Hulumtimi synon të analizojë faktorët politikë, ushtarakë dhe shoqërorë që ndikuan në emigrimin e detyruar, si dhe të vlerësojë ndikimin e këtij fenomeni në ndryshimet demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë shqiptare strukturën familjare.

Në fokus të studimit janë rrethanat politike dhe ushtarake që nxitën shpërnguljen masive të popullsisë shqiptare, drejtimit kryesore të lëvizjes së saj, si dhe ndikimi që ky proces ushtroi mbi zhvillimin e mëvonshëm të shoqërisë shqiptare.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë faktorët politikë, ushtarakë dhe shoqërorë që kushtëzuan emigrimin e detyruar të shqiptarëve, duke vlerësuar njëkohësisht ndikimin e këtij fenomeni në transformimet demografike, ekonomike dhe shoqërore të trojeve shqiptare. Në këtë kuadër, studimi i kushton vëmendje të veçantë pasojave të shpronësimit, shkatërrimit të bazës ekonomike të familjeve shqiptare, dobësimit të strukturave tradicionale shoqërore, si dhe ndryshimeve të shkaktuara në organizimin familjar dhe në dinamikën e zhvillimit ekonomik të vendit. Përmes një qasjeje analitike dhe historiografike, punimi synon të kontribuojë në një kuptim

më të plotë të emigrimit të detyruar si një nga pasojat më të rëndësishme të Luftërave Ballkanike dhe të ndikimit të tij afatgjatë në historinë moderne të shqiptarëve.

Objektivat specifike të hulumtimit janë:

- Analizimi i rrethanave historike dhe politike që çuan në emigrimin e detyruar të shqiptarëve;
- Identifikimi i zonave më të prekura dhe drejtimeve kryesore të emigrimit;
- Shqyrtimi i pasojave shoqërore dhe demografike të emigrimit;
- Analizimi i ndikimit ekonomik të humbjes së pronës, tokës dhe fuqisë punëtore;
- Vlerësimi i rolit të emigrimit në transformimin e strukturës shoqërore të shqiptarëve.

Pyetjet hulumtuese

1. Cilat janë faktorët kryesorë historikë, politikë dhe ushtarakë që kushtëzuan emigrimin e detyruar të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe?
2. Në çfarë mase dhe në cilat mënyra emigrimi i detyruar ndikoi në transformimin e strukturës ekonomike të shoqërisë shqiptare?
3. Si u reflektuan pasojat e këtij emigrimi në strukturën shoqërore, veçanërisht në organizimin familjar dhe marrëdhëniet komunitare?

Metodologjia e punimit

Ky hulumtim mbështetet në metodën historiko-analitike, të kombinuar me qasjen krahasuese, të cilat mundësojnë një trajtim të gjithanshëm të fenomenit të emigrimit të detyruar të shqiptarëve gjatë Luftërave Ballkanike (1912–1913). Në realizimin e studimit janë shfrytëzuar burime primare, si dokumente arkivore, dokumente zyrtare dhe shtypi i kohës, të cilat ofrojnë dëshmi të drejtpërdrejta mbi zhvillimet historike të periudhës. Njëkohësisht, janë konsultuar burime sekondare, të përbëra nga literatura shkencore vendore dhe ndërkombëtare që trajton Luftërat Ballkanike, proceset migratore dhe transformimet shoqërore e ekonomike të shqiptarëve.

Analiza është ndërtuar mbi interpretimin kritik, krahasues dhe kontekstual të burimeve historike, me synim evidentimin e shkaqeve, dinamikës dhe pasojave të emigrimit të detyruar në kuadrin e zhvillimeve politike dhe shoqërore të fillim shekullit XX.

Struktura e punimit

Ky punim është i strukturuar në pesë kapituj. Në kapitullin I, janë trajtuar shkaqet e Luftërave Ballkanike, duke filluar nga gjendja politike e cila ishte e paqëndrueshme, pasi Perandoria Osmane, që kishte sunduar këto territore për shekuj, po dobësohej gradualisht. Çdo shtet synonte të zgjerohej duke marrë pjesë të territoreve osmane që ishin banuar nga popullsi të ndryshme. Gjithashtu është trajtuar edhe roli i Fuqive të Mëdha (si Austro-Hungaria, Rusia, Britania e Madhe dhe Franca), këto fuqi mbështesnin ose pengonin plane territoriale për të ruajtur balancën e fuqive në Europë, duke krijuar tensione shtesë dhe duke favorizuar shpërthimin e konfliktit.

Kapitulli i dytë trajton periudhën ku shqiptarët u përballën me një situatë jashtëzakonisht të vështirë, që detyroi një pjesë të madhe të popullsisë të largohej nga trojet e veta. Shkatërrimi i fshatrave, luftimet e drejtpërdrejta, plaçkitjet dhe masakrat e ushtrive pushtuese krijuan një klimë pasigurie dhe frike, duke i bërë banorët të kërkonin shpëtim në vendet më të sigurta.

Në kapitullin e III, IV dhe V, analizohet mënyra se si shpërnguljet masive ndikuan në dobësimin e ekonomisë tradicionale, në rënien e prodhimit bujqësor dhe në ndryshimin e strukturës së jetës ekonomike lokale. Po ashtu, shqyrtohen pasojat shoqërore të këtij emigrimi, duke përfshirë prishjen e strukturës familjare, dobësimin e lidhjeve komunitare dhe transformimet e përgjithshme në organizimin shoqëror të popullsisë shqiptare.

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e hulumtimit mundësuan vërtetimin e hipotezës kryesore, sipas së cilës emigrimi i detyruar i shqiptarëve gjatë Luftërave Ballkanike (1912–1913) ishte pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve ushtarake, dhunës sistematike dhe politikave të spastrimit etnik të zbatuara nga ushtritë e shteteve ballkanike në trojet shqiptare. Po ashtu, u vërtetua edhe hipoteza e dytë, e cila argumentonte se shpërngulja masive e popullsisë shqiptare shkaktoi ndryshime të thella

demografike dhe shoqërore, duke ndikuar në shpopullimin e shumë vendbanimeve, dobësimin e strukturës familjare dhe prishjen e organizimit tradicional të komuniteteve shqiptare. Njëkohësisht, analiza e pasojave ekonomike dëshmoi vlefshmërinë e hipotezës së tretë, pasi emigrimi i detyruar u shoqërua me humbje të konsiderueshme të pronës, tkurrje të aktivitetit bujqësor, tregtar dhe zejtar, si dhe me një varfërim afatgjatë që ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të trojeve shqiptare edhe në periudhat pasuese.

Përfundimet

Hulumtimi arrin në përfundimin se emigrimi i detyruar i shqiptarëve gjatë Luftërave Ballkanike (1912–1913) përbënte një nga pasojat më të rënda të konfliktit, me ndikime të thella dhe afatgjata në zhvillimin demografik, shoqëror dhe ekonomik të trojeve shqiptare. Dhuna ushtarake, politikat e spastrimit etnik dhe ndryshimet territoriale krijuan kushtet që nxitën shpërngulje masive të popullsisë, duke shkaktuar shpopullim të shumë vendbanimeve, humbje të konsiderueshme të pronës dhe dobësim të bazës ekonomike të familjeve shqiptare. Analiza e burimeve historike dëshmon se pasojat e këtij procesi nuk u kufizuan vetëm në periudhën e luftës, por ndikuan edhe në transformimin e strukturave shoqërore, në ndryshimin e dinamikave demografike dhe në zhvillimin ekonomik të trojeve shqiptare në dekadat pasuese. Në këtë kuptim, studimi evidenton se emigrimi i detyruar duhet të trajtohet jo vetëm si një pasojë e drejtpërdrejtë e Luftërave Ballkanike, por edhe si një proces historik që la gjurmë të qëndrueshme në kujtesën kolektive dhe në evolucionin historik të shoqërisë shqiptare.

Fjalët kyçe: *Luftërat Ballkanike, emigrimi, dhuna, transformimet, ekonomia.*